



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Prezenca në Shqipëri

**FJALA E MBAJTUR NGA KREU I PREZENCËS SË OSBE-SË NË TAKIMIN E
KOMISIONERËVE TË ZGJEDHJEVE
24 QERSHOR 2010**

Kryetari Ristani, Zv/Kryetarja Subashi, anëtarë të KQZ-së, zonja dhe zotërinj, mirëdita!

Jam shumë i gëzuar që jam këtu sot në këtë takim të rëndësishëm.

Ky aktivitet përbën një pjesë të mbështetjes që Prezenca e OSBE-së në Shqipëri i ofron KQZ-në me qëllim përmirësimin e administrimit të zgjedhjeve.

Pikësëpari, dëshiroj të përgëzoj Kryetarin Ristani, Zv/Kryetaren Subashi dhe gjithë anëtarët dhe stafin e KQZ-së për përkushtimin dhe përpjekjet e tyre në përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve parlamentare të 2009-ës.

Një pjesë e rëndësishme e kësaj pune ishin edhe marrëdhëniet e vendosura midis KQZ-së dhe komisioneve të tjera zgjedhore.

Megjithëse vihet re një përparim i dukshëm në funksionimin e këtyre komisioneve, ka, sigurisht, edhe disa fusha që paraqesin sfida për t'u kapërcyer e që kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm në të ardhmen.

Në këtë kuadër, aktiviteti i sotëm fokusohet tek asistenca për KQZ-në, si organi më i lartë i administrimit të zgjedhjeve, si dhe tek përpjekjet e tij për t'i forcuar edhe më shumë lidhjet me komisionet e niveleve më të ulëta zgjedhore dhe veçanërisht me Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ).

Aktiviteti i sotëm vjen si faza përfundimtare e një projekti që Prezenca ka me KQZ-në.

Në fazën e parë, KQZ-së iu ofrua asistencë për krijimin me sukses, për herë të parë, të një baze profesionale të dhënash të plota për të gjithë komisionerët e KZAZ-ve që shërbyen në zgjedhjet parlamentare të vitit të kaluar.

Kjo bazë të dhënash jo vetëm që do t'i japë mundësi KQZ-së të ketë të dhëna të hollësishme elektronike mbi të gjithë komisionerët e KZAZ-ve, por lehtëson, gjithashtu, edhe gjetjen apo përditësimin e të dhënave të tyre kur atyre u kërkohet të shërbejnë përsëri si anëtarë të komisioneve zgjedhore.

Sot do të shohim krijimin e Forumit të Komisionerëve Zgjedhorë si një organ joformal për gjithë komisionerët që gjenden në këtë bazë të dhënash.

Ky është takimi inauguroes i këtij forumi, me pjesëmarrjen e rreth 50 komisionerëve, që kanë shërbyer si kryetarë dhe nënkryetarë të më shumë se një të tretës së gjithë KZAZ-ve në gjithë vendin.

Ky takim do të shërbejë si një forum joformal, ku komisionerët dhe pjesëmarrësit e tjerë mund të shkëmbejnë përvojat e tyre në administrimin e zgjedhjeve të fundit, të diskutojnë çështjet më problematike me të cilat u është dashur të përballen, si dhe të ndajnë me njëri-tjetrin mënyrat se si i kanë zgjidhur ato.

Ne shpresojmë që ju të arrini në sugjerime për një zbatim më të mirë e për t'i përmirësuar edhe më shumë aspektet teknike të administrimit të zgjedhjeve, të cilat do të jenë shumë të vlefshme për rritjen e njohurive profesionale të KQZ-së mbi administrimin e zgjedhjeve.

Unë kam besim se ky aktivitet do të kontribuojë për forcimin e mëtejshëm të një lidhjeje të qëndrueshme midis KQZ-së dhe KZAZ-ve.

Ky është një zhvillim shumë pozitiv që tregon se KQZ-ja mbetet plotësisht e fokusuar tek mbledhja e praktikave më të mira prej atyre që i kanë prekur me duart e tyre aspektet teknike të zgjedhjeve.

Në këtë kontekst, megjithë progresin e dukshëm që është bërë nga KQZ-ja dhe komisionet e niveleve më të ulëta në administrimin e procesit e që është vënë në dukje nga ODIHR-i në raportin e tij përfundimtar, më lejoni t'i kujtoj këtij forumi të rëndësishëm rekomandimet kryesore të ODIHR-it që lidhen me administrimin e zgjedhjeve.

Është vendimtare që për garantimin e administrimit të pavarur dhe profesionist të zgjedhjeve, partive politike nuk u duhet lejuar që t'i zëvendësojnë anëtarët e komisioneve të niveleve më të ulëta në mënyrë arbitrare. Zëvendësime të tilla duhet të lejohen vetëm për arsye specifike të parashikuara qartë nga kuadri ligjor.

Përveç kësaj, Kodi Zgjedhor duhet të garantojë mekanizma efektivë për plotësimin e vendeve të lira në administratën zgjedhore në rast se partitë politike nuk ushtrojnë të drejtën e tyre për të bërë emërimet brenda afateve të përcaktuara.

Përfundimisht, komisionerët zgjedhorë, ashtu sikurse të zgjedhurit dhe zyrtarët e emëruar të të gjitha niveleve, duhet të mos i bazojnë veprimet dhe vendimet e tyre në lidhje me zgjedhjet mbi konsideratat e tyre politike.

Unë besoj se këto janë rekomandime shumë të rëndësishme dhe do t'u bëja thirrje autoriteteve përkatëse që të bëjnë të pamundurën për t'i marrë ato parasysh dhe për t'i zbatuar siç duhet. Sa më shpejt të diskutohen rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe ODIHR-it dhe zbatimi i tyre, aq më mirë.

Më lejoni të shpreh edhe një herë konsideratat e mia më të larta për institucionin e KQZ-së.

Do të doja ta garantoja këtë institucion për mbështetjen që Prezenca do të vazhdojë t'i ofrojë në punën e tij për administrimin e proceseve zgjedhore dhe pres të shoh një bashkëpunim të suksesshëm në të ardhmen.

Faleminderit shumë dhe ju uroj të keni një takim shumë të suksesshëm.

FUND

KONTROLLO PËRKUNDREJT FJALIMIT TË MBAJTUR!